

VENDIM
Nr.29, datë 20.1.2010

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË PËRHERSHËM, PËR KTHIMIN NË
ATDHE TË ESHTRAVE TË PERSONALITETEVE TË SHQUARA SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Qendror të Përhershëm, për përjetësimin e veprës dhe të kontributit në dobi të atdheut të personaliteteve dhe të figurave të shquara kombëtare.

2. Ky komision të kryesohet nga Ministri i Brendshëm dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:

- zëvendësministrin e Punëve të Jashtme;
- zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- sekretarin e Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme;
- drejtorin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Gjithashtu, komisioni fton, në cilësinë e anëtarit pa të drejtë vendimmarrjeje, sipas rastit, edhe 1 përfaqësues të familjes së personalitetit.

3. Komisioni, nëpërmjet Ministrit të Brendshëm, propozon për miratim projektaktet përkatëse, në Këshillin e Ministrave, për kthimin në atdhe të eshtrave dhe organizimin e ceremonisë zyrtare për personalitetet dhe figurat e shquara kombëtare, për çdo rast.

4. Efektet financiare që rrjedhin, sipas rastit, të përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë, fushës së të cilës i përket personaliteti.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Komisioni Qendror i Përhershëm dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha